



Sezoni turistik veror

MZHETTS dhe AKT, fushatë sensibilizuese për plazhe të pastërta

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, së bashku me Agjencinë Kombëtare të Turizmit, kanë nisur një aksion sensibilizues për pastërtinë në plazhe. Nga monitorimet gjatë muajve Korrik-Gusht, të zhvillura nga ekipet e MZHETTS, AKT dhe AKB, rezulton se ka ndotje në disa plazhe gjatë vijës bregdetare. Pavarësisht se në stacionet e plazhit janë vendosur koshat për hedhjen e mbeturinave, pushuesit nuk kujdesen sa duhet që në fund të ditës mbeturinat t'i largojnë nga vendi i zgjedhur për të pushuar. Për të minimizuar ndotjen në plazhet e evidentuara nga monitorimi me probleme, nga Himara, ekipet e MZHETTS dhe AKT nisën aksionin sensibilizues, çadër më çadër, duke u shpërndarë pushuesve qese plastike për hedhjen e mbeturinave. Dita e parë e këtij aksioni nisi nga plazhet e Himarës, Jalit, Dhërmiut dhe Drymades. Ndërkohë një tjetër grup shkoi në Plazhin e Semanit, i cili është zgjedhur nga mijëra pushues vendas dhe të huaj.

Ministrja Milva Ekonomi për iniciativën e Plazhe të Pastërta thotë: “Është përgjegjësi e secilit prej nesh të kujdeset për pastërtinë e plazheve. Grupet e punës nga MZHETTS-si dhe AKT-ja do të vijojnë sensibilizimin për të patur ambiente pushimi sa më të pastra pasi kjo, në fund të ditës, është në interes të vetë pushuesve, të cilët i rikthehen një ditë më pas po të njëjtave plazheve”.

Nga plazhi i Dhërmiut, Leonard Maçi i Agjencisë Kombëtare të Turizmit përcolli këtë mesazh: “Kjo fushatë është në shërbim të sensibilizimit të pastërtisë në plazhe për personat që popullojnë stacionet e plazhit. Mendoj se kjo do të na sjellë një rezultat pozitiv. Vërejmë se ndotësit janë vetë pushuesit, të cilët nuk respektojnë kushtet më minimale të largimit të mbeturinave. Nëpërmjet kësaj initiative, ne kërkojmë të përcjellim këtë mesazh. Ta duam plazhin dhe të respektojmë ambientin ku ne qëndrojmë dhe pushojmë”.


Nëpërmjet një infografi të postuar në Twitter, Ministrja Milva Ekonomi thotë se janë 18% më shumë vizitorë të huaj për periudhën 1 Qershor 10 Gusht 2016 në portin e Vlorës dhe Sarandës krahasuar me të njëjtën periudhë të 2015-ës. Megjithatë sfida e pastërtisë së plazhe mbetet një sfidë e përbashkët mes pushtetit vendor që menaxhon stacionet e plazheve dhe vetë qytetarëve.

Porti i Vlorës dhe Sarandës 18% më shumë vizitorë të huaj për këtë sezon turistik



Shqipëria duket se po kthehet në një destinacion turistik tërheqës për vizitorët e huaj. Një gjë të tillë e dëshmojnë edhe statistikat zyrtare, sipas të cilave, numri i turistëve që vizitojnë vendin tonë është gjithmonë në rritje. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, ka bërë të ditur se numri i vizitorëve për këtë sezon, në portin e Vlorës dhe të Sarandës, është rritur me 18 për qind gjatë periudhës 1 qershor deri 10 gusht 2016, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2015. “Numri i vizitorëve të regjistruar në sportelet pritës u rrit me 18 %, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Ndërsa, numri i vizitorëve shtetas të huaj që mbërritën në portin e Vlorës dhe Sarandës gjatë periudhës 1 qershor deri 10 gusht 2016, u rrit në 52 917, kundrejt 44 722 vizitorëve në vitin 2015”, ka shkruar Ministria Ekonomi në një postim në rrjetin social Twitter. Gjatë vitit 2015, numri i vizitorëve të huaj arriti në 3.945.000, ose 13.8% më shumë në krahasim me një vitin 2014, ndërkohë që ky numër pritet të rritet këtë vit.

26.4 % më shumë biznese të regjistruara në janar-korrik 2016 Rritja reale e bizneseve të regjistruara në vend



Nismat e qeverisë po adresojnë përmirësim të vazhdueshëm të klimës së biznesit, e cila po reflektohet në rritjen e numrit të sipërmarrjeve të reja, të cilat krijohen në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së vendit. Sipas të dhënave nga Qendra Kombëtare e Biznesit, numri i bizneseve të regjistruara gjatë periudhës janar-korrik 2016 është rritur me 26.4 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2015 numri i bizneseve të regjistruara ishte 10.400, ndërsa në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2016 ky numër është 13.146. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, i ka bërë të ditura këto të dhëna nëpërmjet një postimi në rrjetin social “Facebook”, duke theksuar se: “Rritja reale e bizneseve të regjistruara në vend, janë shifrat që flasin vetë”. Ecuria pozitive e treguesve ekonomikë konfirmohet edhe Banka e Shqipërisë. Në raportin e publikuar se fundi, Banka e Shqipërisë parashikon se trajektorja pozitive e zhvillimeve ekonomike e financiare do të vijojë të ruhet edhe në të ardhmen. Sipas BSH-së, ekonomia shqiptare këtë vit po shënon rritjen më të lartë krahasim me një vit më parë, trend i cili pritet të forcohet gjatë viteve në vijim.

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave njoftoi çeljen e konsultimeve publike për projektligjin “Për pronësinë industriale”. Projektligji është publikuar në faqen zyrtare dhe DPPM ka ftuar grupet e interesit të bëjnë komentet dhe rekomandimet e tyre deri në datën 16 gusht. P/ligji ka në fokus ndryshimin e strukturës organizative dhe funksionale të DPPM-së me qëllim forcimin e kapaciteteve administrative dhe financiare, si element kryesor i realizimit të misionit të saj. Po ashtu, përmes tij synohet ndryshimi i strukturës administrative të DPPM-së nga një institucion publik buxhetor në një Shoqëri Anonime ose Agjenci Autonome në kuptim të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.” Zyrat homologe në BE, si dhe në vendet e zhvilluara në botë, thotë DPPM-ja përgjithësisht kanë këto forma organizimi. Sipas DPPM-së, ky projektligj bën edhe përcaktimin ligjor të rregullave për markat e mirënjohura, si dhe hartimin e kritereve për ekspertët që Gjykata dhe Prokuroria përcakton për objektet e PI-së e krijimin e një mjedisi ligjor për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe të komunikimit. Ndër të tjera, ai krijon mundësi të aplikimit on-line dhe rishikimit të bazës ligjore për Përfaqësuesit e Autorizuar .



Publikimet, informimi dhe komunikimi me palët


Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ka vijuar publikimin e standardeve të reja në faqen e saj të internetit dhe në rrjetet sociale. Tre standardet e publikuara gjatë kësaj periudhe janë: SSH EN 12473:2014 "Parime të përgjithshme të mbrojtjes katodike në ujin e detit"; SSH EN ISO 5530-2:2014 "Miell gruri - Karakteristikat fizike të brumit - Pjesa 2: Përcaktimi i vetive reologjike duke përdorur pajisjen ekstensograf"; SSH EN 62870:2015 "Instalime elektrike për ndriçimin dhe sinjalistikën e aerodromeve - Qarqet dytësore të sigurisë në qarqet e kontrollit - Kërkesa të sigurisë së përgjithshme". Gjithashtu, është publikuar edhe shkrimi me titull: “Çdo pikë uji e vlefshme dhe trajtimi i ujërave të zeza për përdorim në bujqësi nëpërmjet standardeve ndërkombëtare”. Shkrimi tërheq vëmendjen drejt përdorimit të standardeve ndërkombëtare për trajtimin e ujërave të zeza, të cilat ndihmojnë të maksimizohen përfitimet nga vaditja e vazhdueshme dhe zvogëlojnë risqet që lidhen me sistemet bujqësore të vaditjes. DPS bën të ditur se janë shitur 25 standarde shqiptare të fushës së cilësisë së ujit, fruta perime dhe akustika.

Shqipëria Turistike

“Telegraph” fton lexuesit e saj në një tur nëpër Shqipëri

Gazeta e njohur britanike “Telegraph” fton lexuesit e saj në një tur nëpër Shqipëri, për të zbuluar një vend, që ajo e quan me bukuri mahnitëse. Të ftuar në këtë tur si miq specialë do jenë dy gazetarë shumë të njohur britanikë, John Stapleton dhe Lynn Faulds Wood. Udhëtimi zgjat tetë ditë dhe nis nga Tirana. Më pas do të udhëtohet në Krujë dhe në Shkodër. Nga Shkodra do shkohet në Elbasan dhe në Liqenin e Ohrit. Në kthim do të vizitohet Berati, Gjirokastra dhe Saranda. Turi do të vazhdojë në Parkun Kombëtar të Llogarasë dhe do të përfundojë në Durrës. <http://www.telegraph.co.uk/travel/tours/telegraph-tours/albania-with-special-guest-john-stapleton/#>

Me një vijë bregdetare të gjatë të detit Adriatik, Shqipëria është një nga vendet më të bukura në Europë, por ende një nga më pak të vizituarat, ku e kaluara mistike komuniste po tërheqin vizitorë nga e gjithë bota.



Vendet ballkanike në festivalin e filmit Ballkanik dhe Kulinarisë në Pogradec




Festivali i Filmit Ballkanik dhe Kulinarisë u zhvillua në qytetin e Pogradecit, ku morën pjesë prodhimet filmike më të mira nga vendi dhe trevat e Ballkanit. Ky aktivitet artistik përkon me kulmin e sezonit turistik në këtë qytet dhe shërben si një promovim, jo vetëm për artin e kinemasë por, dhe për turizmin në brigjet e Ohrit. Pushues të shumtë nga vendi dhe bota kanë mbushur brigjet e liqenit dhe hotelerinë e qytetit. Agjencia Kombëtare e Turizmit mori pjesë në ceremoninë e hapjes së Festivalit të Filmit dhe Kulinarisë. Në këtë aktivitet ishin prezent dhe përfaqësues të Shoqatës së Restoranteve Turistike Shqiptare dhe shoqatës së Shefave të Kuzhinës të cilët, së bashku me AKT-në, shpërndanë disa çertifikata mirënjohje për restorant Boboshticën, Restorant Rushi Pogradec, Shoqata e Verërave Familjare Shehi, Kantina Sallaku etj.

AKT ishte prezent në këtë aktivitet me materiale promovuese dhe materiale informative për zona të ndryshme turistike që u shpërndanë për të gjithë pjesëmarrësit. Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Turizmit Ardit Çollaku, në fund të fjalës së tij përshëndetëse, dhuroi në mënyrë simbolike edhe disa albume fotografike me pamje nga zonat më të bukura shqiptare për disa nga aktorët dhe regjisorët e famshëm shqiptar si Roza Anagnosti, Bujar Kapexhiu, Tinka Kurti, Mirush Kabashi etj.

Festivali Ndërkombëtar i Teatrit të Butrintit, edicioni i 14

Për të dytin vit radhazi, Agjencia Kombëtare e Turizmit bashkëpunon me Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit në Butrint. Edicioni i 14-të i këtij festivali u zhvillua në datat 19-23 korrik ku morën pjesë trupa teatrore nga Shqipëria, Greqia dhe Spanja. Të ftuar në këtë event ishin kryetarja e bashkisë së Sarandës, znj. Florjana Koka dhe përfaqësues nga Ministria e Kulturës. Agjencia Kombëtare e Turizmit ishte pjesëmarrëse në këtë event të cilësuar si një nga më të rëndësishmit ku, përveç të tjerash, u diskutua për vijimësinë e bashkëpunimit edhe në vitet në vazhdim.



Agjencia Kombëtare e Turizmit, pjesëmarrëse në promovimin e eventit të “Kampionatit European të Bilardos”

Agjencia Kombëtare e Turizmit mori pjesë edhe këtë vit në organizimin dhe promovimin e eventit të Kampionatit European të Bilardos, me 10 gurë, për kategori femra dhe meshkuj, me 202 pjesëmarrës nga e gjithë Europa. Integrues, ky event bëri të mundur tërheqjen e vëmendjes së shumë dashamirësve të sportit në përgjithësi dhe bilardos në veçanti. Pjesëmarrësve të huaj përgjatë këtij eventit, të cilët garuan, iu ofrua mundësia për të shijuar natyrën e kryeqytetit dhe rrethinave përfaqë, duke mbetur të mahnitur nga bukuritë që kjo zonë ofron me anë të minitureve familjarizuese. AKT, gjatë zhvillimit të aktivitetit, shpërndau material promocional për pjesëmarrësit dhe duke shpërndarë kështu njohuritë dhe mundësitë e një kontakti të prekshëm lidhur me turizmin. Shqipëria bëri të mundur që me 12 bilardistë pjesëmarrës në event të shtojë interesin publik dhe institucional rreth kësaj atraktive sportive me kaq peshë në rangun european dhe botëror. Projekte të tilla do të jenë gjithmonë në vëmendjen kryesore të promovimit të turizmit, të kulturës dhe sportit me finalizimin dhe jehonën gjithëpërfshirëse të vendit tonë në rajon e me gjerë duke siguruar partnership të pashmangshëm.

Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania
Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55
E-mail: info@ekonomia.gov.al
Web: www.ekonomia.gov.al

